



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.342/2022

GJYKATA KOMERCIALE, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren individuale Franciska Zhitija Ymeri, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “A...” SH.P.K., me seli në Komuna Fushë Kosovë, kundër debitorit NNP “SH...” në Prishtinë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, PPP.nr.417/2019 të datës 11.09.2019, me datë 31.08.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e kreditorit “A...” SH.P.K., Komuna Fushë Kosovë, ANULOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, PPP.nr.417/2019 të datës 11.09.2019, dhe lënda i kthehet Gjykatës Komerciale – Dhomës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e ankimuar, PPP.nr.417/2019 të datës 11.09.2019, ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit NNP “SH...” NRB ..., në Prishtinë dhe ka shfuqizuar urdhrin për përmbarim P.nr.22/2019 të datës 14.02.2019 të lëshuar nga përmbaruesi privat për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe ka abroguar të gjitha veprimet e ndërmarra deri më tani në këtë çështje përmbarimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aktvendimi i ankimuar të prishet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, përmes gjyqtares individuale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 3 paragrafi 2 dhe nenin 17 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori kreditorit “A...” SH.P.K., Komuna Fushë Kosovë, me datë 14.02.2019, ka paraqitur propozim për përmbaram kundër debitorit NNP “SH...” në Prishtinë, në bazë të dokumenti të besueshëm – faturës nr.002/16-SHKO të datës 30.05.2016, faturës nr.003/16-SHKO të datës 23.06.2016, faturës nr.004/16-SHKO të datës 25.11.2016 dhe faturës nr.001/17-SHKO të datës 14.02.2017, për shumën e përgjithshme të detyrimit prej 35.692.84 Euro.

Përmbaruesi privat Eset Murati, duke vepruar sipas propozimit për përmbaram të kreditorit me urdhrin P.nr.22/2019 të datës 14.02.2019, ka lejuar përmbaramin, duke vlerësuar se faturat e lëshuar nga kreditori i plotësojnë kushtet për përmbaram. Kundër këtij urdhri debitori ka paraqitur prapësim me datë 27.02.2019, duke e kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbaramor, me propozim që të refuzohet propozimi për përmbaram në tërësi si i pabazuar. Përgjigje në prapësim ka parashtruar kreditori me datë 04.03.2019, me propozim që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit të prapësimi dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar PPP.nr.417/2019 të datës 11.09.2019, me të cilin ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit dhe ka shfuqizuar urdhrin përmbaramor P.nr.22/2019 të datës 14.02.2019, duke vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka theksuar pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, në rastin e rishikimit të procedurës në këtë çështje përmbaramore erdhi në përfundim se urdhri përmbaramor i përmbaruesit privat si organ përmbarues është nxjerrë pa u plotësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e urdhrin përmbarues, për faktin se dokumenti i besueshëm fatura në bazë të së cilit në petituimin e propozimit për përmbaram është kërkuar nga kreditori që te vërtetohet përmbarami, nuk përbënë bazë juridike për caktimin e përmbaramit siç është përcaktuar me nenin 21, 29 paragrafi 1.1.3 dhe paragrafi 3 të LPP-së, për shkak se nuk është pranuar dhe e nënshkruar nga debitori i përmbaramit.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, duke e vlerësuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë si dhe të gjitha shkresat e lëndës dhe ka gjetur se një aktvendim i tillë është i pabazuar dhe nuk ka mbështetje ligjore dhe as mbështetje në shkresa e lëndës.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se aktvendimi i ankimuar është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1, 182 paragrafi 2, pika n) të LPK-së, e lidhur me nenin 29 paragrafi 1, pika 1.3, nenit 71 të LPP-së, ku gjykata nuk ka zbatuar drejtë dispozitat ligjore dhe kjo ka pasur ndikim në nxjerrjen e vendimit jo të ligjshëm.

Aktvendimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (n) të LPK-së, pasi që dispozitivi i aktvendimit është

i pakuptueshëm, në kundërshtim me arsyet e aktvendimit e po ashtu arsyet e paraqitura lidhur me faktet vendimtare të çështjes janë të mangëta dhe të paqarta.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë tani për tani nuk mund ta pranojë qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë mbi atë se faturat nuk paraqesin dokument të besueshëm dhe se të njëjtat nuk janë pranuar dhe nënshkruar nga debitori, për faktin se po që se i referohemi shkresave të lëndës atëherë vërtetohet se në këtë çështje juridike përmbartimore përmbartimi është lejuar në bazë të dokumentit të besueshëm – faturave dhe atë faturës nr.002/16-SHKO të datës 30.05.2016, faturës nr.003/16-SHKO të datës 23.06.2016, faturës nr.004/16-SHKO të datës 25.11.2016 dhe faturës nr.001/17-SHKO të datës 14.02.2017, për shumën e përgjithshme të detyrimit prej 35.692.84 Euro, të cilat nga ana e kreditorit janë paraqitur në kopje të noterizuara siç parashihet me dispozitat ligjore të LPP-së, e disa nga këto fatura sipas shkresave të lëndës rezultojnë të jenë të nënshkruara nga ana e debitorit, e disa të pranuar përmes formës elektronike, e po ashtu nga shkresat e lëndës shihet se debitori ka kryer pagesa të pjesshme të faturave në fjalë.

Në ri procedurë, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së parë, duhet të veproj në kuptim të vërejtjeve të sipërpërmendura, ashtu që të vlerësojë edhe një herë se a janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 71 të LPP-së për aprovimin e prapësimit të debitorit, nëse është e nevojshme të caktojë përsëri seancë publike për të sqaruar dhe evituar paqartësitë në mes të palëve ndërgjyqëse dhe varësisht nga të gjeturat të marr vendim të drejtë dhe të ligjshëm sipas kërkesave të LPK-së, nga neni 160 paragrafi 3, në atë mënyrë që dispozitivi i vendimit duhet të jetë i kuptueshëm dhe i përmbartueshëm.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhoma e shkallës së dytë
K.DH.SH.II.nr.342/2022, me datë 31.08.2022

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija Ymeri